

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark. nr. 01-4139/1, datë 07.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-1348/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzioni ark. nr. 02-1670/2 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 16-të mbajtur me datë 10.04.2025, miratoi sa vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 51, paragrafit (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiz transmetuar më 4 mars 2025, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr. 10-1348/1, datë 27.03.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), është kompetent të kryen mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe Rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe të tjera akte të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 51, paragrafit (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet përdoruesve të tyre t'u ofrojnë qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, përkatësisht emrin, shenjë mbrojtëse ose shkurtesën e shenjës identifikuese (avizo, logon dhe të ngjajshme); adresën e zyrës qendrore të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv; të dhëna për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audiovizual (numri i telefonit, e-mail adresë dhe/ose uebfaqja, personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe, nëse është e mundur dhe të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 27 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, transmetuar më 4 mars 2025, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV.

Përkatësisht, mbikëqyrja konstatoi se më 4 mars 2025, SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihen në dispozicion përdoruesve, gjegjësisht nuk ka mundur qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku në këto të dhëna: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audioviziv; të dhënat për kontakt (numër telefoni, e-maili dhe/ose uebfaqja; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-1348/1, datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup më 28.03.2025, dërgoi Shkresë ark. nr.10-1348 /2, datë 28.03.2025, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr. 10-1348/1 datë 27.03.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 01.04.2025. Në afatin e paraparë SHTR KLAN MAQEDONI pranuar nga transmetuesi më 01.04.2025 . Në afatin e paraparë SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj Shkup nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 10.04.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, t'i shqiptojë masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-1348/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/2 datë 10.04.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.04.2025, miratoi Aktvendim që publikisht paralajmëron SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit..

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark. nr.10-1348/1 datë 27.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.